



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.____.2026

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Data 07.08.2026

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Preng Cara Cara” PF, me numër NIPTI **L08003301A**,
Adresa: Lac LAC Lagjja nr1, Rruga Unaza, Ndertese 5 katesh, kati 1, Zona Kadastrale nr.2364. me Pasuri nr.1/530.

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-92607-07-07-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Ushqimesh për fëmijët e Çerdhes, Bashkia Kurbin”.

Fondi limit: **2,083,129** (dy milion e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: 30.07.2026.

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: Nr.48, datë 03.08.2026.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “M.C.CATERING” SHPK, me numër NIPTI K72218022J.

Vlera e ofertuar: **1,998,390** (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “Preng Cara Cara” PF, me numër NIPTI L08003301A.

Vlera e ofertuar: 2,077,365 (dy milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “M.C.CATERING” SHPK, me numër NIPTI K72218022J.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:**

- **OE “M.C.CATERING” SHPK skualifikohet, pasi nuk plotëson pikën 2.4.1 të kritereve të veçanta të kualifikimit në DST.**

Autoriteti Kontraktor në DST në pikën 2.4.1 nder të tjera ka kërkuar: *2.4.1 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë: Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se disponon ambient (ushqimore) në territorin e Bashkisë Kurbin (e verifikueshme në QKB).*

Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ka paraqitur deklaratë në të cilën ka deklaruar se: *Disponojmë ambient thertore me kontrate furnizimi ne qytetin e Tiranës, konkretisht me subjektin “Pajtim Zeka” pf me Nipt: L31525005M.* Gjithashtu Komisioni verifikoi edhe ekstraktin historik në të cilin rezultoi se ky operator ekonomik nuk disponon ambient në territorin e Bashkisë Kurbin, pasi nuk ka të hapur nipt sekondar në Bashkinë Kurbin.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Preng Cara Cara” PF, me adresë: Lac LAC Lagjia nr1, Rruga Unaza, Ndertese 5 katesh, kati 1, Zona Kadastrale nr.2364. me Pasuri nr.1/530, se oferta e paraqitur me vlerë të përgjithshme prej: 2,077,365 (dy milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kurbin, adresa: Lagjia Nr.3, Laç (në zyrën e protokollit të Bashkisë Kurbin), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të veprohet, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit:

JO (Nuk ka patur)

Titullari i Autoritetit Kontraktor
Majlinda CARA